



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 310/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga Rafet Haxhaj, kryesues, Nehat Idrizi dhe Vlastimir Dimiç, anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Aleksandar Zdravkovic kandidat për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik Srpska Social Demokratska Stranka (SSDS) nga fshati Staro Gradsko komuna e Lipjanit, që ka të bëjë me tërheqjen nga lista e kandidateve, në seancën e mbajtur me datë 02.12.2010 mori këtë:

VENDIM

HIDHET poshtë apeli si i pasafatshëm .

ARSYETIM

Aleksandar Zdravkovic kandidat për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik SSDS nga fshati Staro Gradsko komuna e Lipjanit, ka parashtruar apel për tërheqjen nga lista e kandidateve për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës.

Parashtruesi i apelit ka deklaruar se është njoftuar se gjendet në listën e kandidateve të subjektit politik SSDS dhe se për këtë kurrë nuk ka pranuar apo nënshkruar ndonjë deklaratë për të qenë në atë listë. Ai shton se nëse figuron nënshkrimi i tij në atë dokument atëherë me përgjegjësi deklaron që ai nënshkrim është i falsifikuar .

Parashtruesi i apelit kërkon që PZAP-i të bëjë fshirjen e emrit të tij nga lista e kandidateve të subjektit politik SSDS sepse sipas tij nuk do të mund të jetë kandidat për arsye se kjo do të ishte në kundërshtim me përshkrimin e punës së tij.

FAKTET

PZAP ka pranuar një apel më datë 01.12.2010 nga Aleksandar Zdravkovic kandidat për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik Srpska Socialdemokratska Stranka (SSDS) nga fshati Staro Gradsko komuna e Lipjanit, i cili kërkon tërheqjen nga lista e kandidatëve nga ky subjekt politik .

Parashtruesi i apelit ka pohuar se kandidimi i tij është bërë pa pëlqimin e tij në listën e kandidatëve për deputet me numër rendor 39.

ANALIZË

Juridiksioni i PZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me autorizimin e dhënë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në Ligjin Nr. 03/L-256, dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-072).

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidatëve nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (Nr. 03/L-073),

Neni 122 pika c) LZP përcakton:

Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të cilat janë prekur nga cilat do vendime të më poshtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apeloj atë vendim në PZAP brenda 24 orëve pasi që vendimi i apeluar shpallet nga KQZ-ja dhe apeli duhet vendoset nga PZAP-i brenda shtatëdhjetedy (72) orëve pasi të jetë parashtruar apeli.

c) kandidatin i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;

Lista e kandidatëve konsiderohet të jetë e certifikuar nga KQZ-ja në kohën e tërheqjes së shortit më 20 nëntor 2010, në ora 17:00 ndërsa afati për parashtrim të apelit në PZAP, në këtë fazë të procedurës ka qenë njëzetekatër (24) orë pas certifikimit gjë që nuk e ka bërë kandidati Aleksandar Zdravković nga SSDS-ja.

Sipas dispozitës së lartcekur PZAP-i konstaton se apeli është i pasafatshëm, sepse apeli në PZAP është pranuar më datë 01.12.2010, ndërsa afati për parashtrim të apelit në PZAP, në këtë fazë të procedurës ka qenë njëzetekatër (24) orë.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 310/2010 më datën 02.12.2010.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

